

Verzioni anglëzë me mbizotru
Енглеска верзија савладати
English version prevails

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Seanca nr.2002/20
Prishtinë, më 14 nëntor 2002, ora 10:15 minuta
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla plenare

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi z.Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.
Kryesuesi konstatoi numrin e deputetëve të pranishëm në seancë, gjithsej 84. Për këtë seancë ishte propzuar ky

REND I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Procesverbali nga seanca e kaluar;
3. Shqyrtimi i dytë i "P/ligjit për Tregti të Jashtme-2002/6";
4. Rekomandimet e Këshillit Gjyqësor dhe i Prokurorisë së Kosovës për emrimin e gjyqëtarëve dhe prokurorëve;
5. Shqyrtimi i parë i "P/ligjit për Pyjet e Kosovës-2002/10"; dhe
6. Parashtrimi i pyetjeve.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryesusi i informoi deputetët e Kuvendit me shkresën që kishte arritur nga Qeveria e Kosovës, me të cilën kërkohet shtyrja e shqyrtimit të parë të "P/ligjit për Pyjet e Kosovës" me arsyetim se në këtë seancë nuk mund të marrë pjesë Ministri i bujqësisë dhe zhvillimit rural, i cili duhet ta arsyetonte P/ligjin dhe këte do ta bëjë në seancën e ardhshme plenare.

Haki Shatri, tha se "P/ligji për Tregti të Jashtme" asnjëherë nuk është shtyer për shkak të mos punës së Komisionit për buxhet. Komisioni nuk ka pasur mundësi t'i shqyrtojnë komentet e këshilltarit juridik të PSSP-së, për shkak se ato kanë ardhur me vonesë, është e pamundur që ato të

shqyrtohen gjatë pauzës eventuale të sotme, andaj ai propozoi që shqyrtimi i dytë i P/ligjit të bëhet në seancën e ardhshme.

Bajrush Xhemajli, tha se Komisioni për Tregti dhe Industri me kohë e ka shqyrtuar “P/ligjin për Tregti të Jashtme”, por zhvaritja e punës dhe mos miratimi i këtij P/ligji është nga ana e UNMIK-ut, i cili i ka bërë komentet-vërejtjet në atë P/ligj dhe ato deri dje nuk kanë qenë të përkthyer dhe nuk kanë mundur t’i shqyrtojnë.

Sadudin Berisha, tha se Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve me kohë e ka shqyrtuar “P/ligji për Tregdi të Jashtme” dhe i ka paraqitur rekomandimet e veta lidhur me te. Ismajl Kurteshi, pyeti se ndërhyrja e UNMIK-ut në “P/ligjin e Tregdisë së Jashtme” mos është tejkalim i kompetencave të tij?

Kryesusi, tha se Sekretaria i ka sygjerruar që ta shtyjë shqyrtimin e dytë të “P/ligjit të Tregtisë së Jashtme” për seancën e ardhshme. Kryesusi konstatoi se u miratua rendi i ditës.

2. Procesverbali nga seanca e kaluar.

Deputetët nuk patën vërejtje në procesverbalin e Seancës së kaluar, andaj ai u miratua.

3. Rekomandimet e Këshillit Gjyqësor dhe i Prokurorisë për emrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kryesusi hapi debat lidhur me ato rekomandime.

Arsim Bajrami, tha se Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe kornizë kushtetues i ka shqyrtuar rekomandimet e Këshillit Gjyqësor dhe i Prokurorisë së Kosovës, për secilin kandidat vec e vec. Dispozitat ligjore për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë parashohin dy kushte themelore: a) të kenë mbaruar studjimet në drejtësi dhe b) të kenë të dhënë provimin e judikaturës. Duke u nisur nga të dhënat që kemi pasur në disponim, tha z. Bajrami kemi bërë një propozim që ka tri rekomandime për Kuvendin e Kosovës: a) kandidatët që rekomandohen t’i propozohen PSSP-së për zgjedhje; b) kandidatët të cilët nuk propozohen për zgjedhje, për shkak se Komisioni ka gjetur të dhëna në karrierën e tyre profesionale pas viteve 90-ta ata kanë qenë të implikuar në sistemin e gjyqësisë, në kohën kur është rrënuar sistemi gjyqësor i Kosovës; dhe c) kandidatët për të cilët Komisioni rekomandon që të shtyhet zgjedhja e tyre, derisa nuk sigurohen të dhëna plotësuese për ta, të cilat janë relevante për punën e Komisionit.

Muhamed Kelmendi, tha se ka marrë pjesë në punën e Komisionit i cili i ka shqyrtuar rekomandimet e Këshillit dhe ka shprehur qëndrimet e tija në dy çështje të rëndësishme. 1) shumica nga të rekomanduarit nuk e kanë të dhënë provimin e jurispodencës dhe 2) ku kanë shërbyer të rekomanduarit pas vitit 89, kur është rrënuar sistemi gjyqësor i Kosovës? Kam të dhëna, tha z. Kelmendi se shumica e të rekomanduarëve kanë vazhduar të

punojnë nëpër gjykatat e instaluara nga pushteti i Serbisë. Andaj, vazhdoi z. Kelmendi, në Komision kam qenë kundër dhe sot është kundër këtij rekomandimi.

Ramadan Kelmendi, tha se në listën e të propozuarëve gjenden kandidatë të cilët në mënyrën më besnike kanë respektuar dhe zbatuar ligjet diskriminuese mbi shqiptarët. Z. Kelmendi përmendi emrat e të rekomanduarëve të cilët kanë punuar në Gjykatën komunale të Mitrovicës, të cilët i janë bashkangjitur transkriptit.

Teuta Hadri pyeti se kush e ka themeluar Këshillin Gjyqësor dhe të Prokurorisë? Nëse ai Këshill, vazhdoi znj. Hadri nuk e përfill mendimin e Kuvendit, atëherë cka kërkojnë nga ne?

Ismajl Kurteshi, tha se deputetët nuk janë në gjendje që të votojnë në mënyrë të drejtë, në bazë të kësaj që i është ofuar atyre vetëm emrat e të rekomanduarëve, pa asnjë shënim tjetër për ta.

Bujar Dugolli, tha se Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë nga PSSP-ja, nëse don miratimin e Kuvendit për listën e propozuar, të jep një kohë më të gjatë që të vendosin për të rekomanduarit. Deputetët nuk mundën të votojnë, vazhdoi z. Dugolli pa pasur informata të plota dhe të sakta për të rekomanduarit. Ai, pyeti se kush e ka formuar Këshillin Gjyqësor dhe të Prokurorisë? Kush janë antarët e tij? Dhe a ka mundësi që Kuvendi i Kosovës ta formojë atë Këshill.

Sadik Idrizi, tha se deputetët nuk kanë mundësi që t'i njohin të rekomanduarit nëpër komunat e tjera të Kosovës, pasi që nuk kanë pasur informatat për ta. Ai, tha se nëpër komunat me popullësi të përzier duhen të emrohen gjyqtarë dhe prokurorë në bazë të strukturës etnike të mjedisit. Në komunën e Sharrit, tha ai është vetëm një gjykatës i nacionalitetit boshnjak.

Bajram Kosumi, tha se gjatë shqyrtimit të të rekomanduarëve në Komision nuk kanë pasur informata të plota për ta. Deputetëve nuk u janë shpërndrë biografite të të rekomanduarëve dhe ata nuk janë në gjendje të votojnë pa pasur informacioni e duhur. Sot, tha ai dëgjova informata të reja për disa të rekomanduar dhe e ndryshon mendimin nga ai i që ka pasur në Komision. Këshilli, tha ai ka rekomanduar edhe asi kandidatë që tërë biogarfine e tyre e kishin: shef i UDB-së, inspektor i lartë, anëtar i shtabit qendror të ushtrisë dhe policisë në Prishtinë. Ai, tha se e mbështet qëndrimin e z. Muhamed Kelmendit.

Kryesusi, tha se çështjet e gjyqësisë, judikaturës dhe sigurimit janë kompetenca të rezervuara të PSSP-së. Ai, propozoi që të votohet emër për emër për çdo të rekomanduar prej Komisionit, kurse për ata që ka vërejtje, të kërkohej nga Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë kompletimi i dokumentacionit me informata shtesë.

Hydajet Hyseni, tha se i mbështet parafolisit e tij lidhur me plotësimin e e informatave për të rekomanduarit nga Këshilli i Gjyqësisë dhe i Prokurorisë. Kuvendi, vazhdoi ai duhet të vendosë në bazë të informacionit të plotë dhe ka nevojë që të sqarohet: cili është statusi i atij Këshilli? Cila është përbërja e tij? Cilat janë kriteret në bazë të të cilave është bërë përzgjedhja e kandidatëve dhe cilët janë kandidatët e refuzuar? Në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, tha z. Hyseni duhet të angazhohet edhe Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës.

Sabri Hamiti,propozoi që diskutimi lidhur me këtë çështje sot të ndërpritet.Të mblidhen të gjitha dokumentet që i ka pasur Kryesia dhe Komisioni i Kuvendit,pastaj të votohet emër për emër. Nëse çështja e emrimit të gjyqtarëve dhe prokurorve,vazhdoi z.Hamiti është e drejtë e rezervuar e z.Shtajner,atëherë ai l'e të shkruajë dekrete dhe l'e t'i emrojë kend të dojë.Por,nëse emron në organet gjyqësore njerëzit që kanë biografi të kriminalizuar,atëherë ai l'e ta merrë edhe përgjësinë për emrimin e tyre,e jo ky Kuvend.

Kryesusi: Në bazë të diskutimeve të deputetëve dhe mendimit të tri grupeve parlamentare propozojqë vendimi për këtë pikë të rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme plenare. Lirak Celaj,tha se mbështet parafolsit e tij,por shtroi çështjen se cili është ai institucion që verifikon saktësinë e biogafive të kandidatëve të rekomanduar për gjyqtarë dhe prokurorë.

Arsim Bajrami,tha se Kuvendi i Kosovës ka të drejtë të diskutojë për këtë çështje dhe nuk është vetëm fushë e rezervuar.Është më se e domosdoshme,vazhdoi ai që në seancat e ardhshme të Kuvendit të hapet debati për gjendjen në sistemin e gjyqësisë në Kosovë.Ai, në vazhdim tha se është zhvilluar intervistim me kandidatët e rekomanduar për gjyqtarë dhe prokurorë. Z Bajrami diskutoi edhe për përbërjen e Këshillit të Gjyqësisë dhe të Prokurorisë.

Hajredin Kuqi,tha se mbështet parafolsit e tij për shtyrjen e kësaj pike të rendit të ditës. Ai,tha se verifikimin e biografive të kandidatëve të rekomanduar për gjyqtarë dhe prokurorë duhet ta bëjë një organ profesional dhe i besueshëm.Në Kosovë ka mbi 8.000 juristë të diplomuar,potenco ai dhe ka mundësi që të bëhet një përzgjedhje më e mirë e tyre.

Kryesusi në bazë të diskutimeve të zhvilluara për këtë pikë të rendit të ditës,konstatoi se kjo çështje të shqyrtohet në mbledhjen e arshme plenare.

4. Të ndryshme -Përgjigjet në pyetjen e deputetëve.

Deputeti Lirak Celaj i kishte parashtruar pyetje Ministrin të ambientit dhe planifikimit hapësinor z.Ethem Ceku, në lidhje me ndotjen e ambientit me materie radioaktive. Përgjigja e z.Ceku i është bashkangjitur transkriptit.

Deputeti Tomë Hajdaraj kishte parashtruar pyetje ministrit të punës dhe mirëqenies sociale z.Ahmet Isufit lidhur me gjendjen sociale të popullatës në Kosovë. Përgjigja e z.Isufi i është bashkangjitur transkriptit.

Kryesusi përfundoi Seancën plenare në orën 11:15

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,
akademik Nexhat Daci